



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/179
Datë: 21.12.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimi Nr. 42/178 i datës 13.12.2022, dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhje e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Reformulohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/128 të datës 16.02.2023, me tekstin si në vijim:
 - Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 9,895,916.66 € (nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent).
2. Reformulohet paragrafi 2.3 i pikës 2. të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/128 të datës 16.02.2023, me tekstin si në vijim:
 - Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, ndahet shuma prej 795,916.66 € (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent) në nën-programin "Ndihmat Sociale" me kod 00500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 3.4 – Kuponë ushqimi për familjet në nevojë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe zbatimin e Masës 3.1 – Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin.
3. Mjetet buxhetore nga 404,083.34 € (katërqind e katër mijë e tetëdhjetë e tre euro e tridhjetë e katër cent) që rezultojnë të lira nga ndryshimi dhe plotësimi sipas pikës 1. dhe 2. të këtij Vendimi, shfuqizohen dhe konsiderohen si të pa alokuara dhe të pashpenzuara, dhe mbesin pjesë e ndarjes buxhetore fillestare.
4. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/128 të datës 16.02.2023 mbesin të pandryshuara.
5. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/179
Datë: 21.12.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimi Nr. 42/178 i datës 13.12.2022, dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Riformulohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/157 të datës 30.08.2023, me tekstin si në vijim:
 - Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 5,928,070 € (pesë milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëdhjetë euro) në zbatim të Masës 4.2 – Mbështetja për Arsimin të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për sigurimin e materialeve mësimore.
2. Mjetet buxhetore nga 689,270.000 € (gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë euro) që rezultojnë të lira nga ndryshimi dhe plotësimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, shfuqizohen dhe konsiderohen si mjete të pa alokuara dhe të pashpenzuara, dhe mbesin pjesë e ndarjes buxhetore fillestare.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/157 të datës 30.08.2023 mbesin të pandryshuara.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/179
Datë: 21.12.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimi Nr. 42/178 i datës 13.12.2022, dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Reformulohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/169 të datës 27.10.2023, me tekstin si në vijim:
 - Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,684,217.54 € (një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë e katër cent) për zbatimin e masës 2.1 – Subvencionimi i kredive investive të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet buxhetore nga 815,782.46 € (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy euro e katër dhjetë e gjashtë cent) që rezultojnë të lira nga ndryshimi dhe plotësimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, shfuqizohen dhe konsiderohen si të pa alokuara dhe të pashpenzuara, dhe mbesin pjesë e ndarjes buxhetore fillestare.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/169 të datës 27.10.2023 mbesin të pandryshuara.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/179
Datë: 21.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 5. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Anexa A (Kursimet)

BLLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Kursime
10/203/40800/13/00000/0421	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHV	AGJENSIONI VETERINAR DHE USHQIM	13	MALLRA DHE SHËRBIME	300,000.00
10/203/40400/13/00000/0421	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHV	DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE KËSHTU	13	MALLRA DHE SHËRBIME	100,000.00
10/206/71300/13/00000/0711	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	SHËRBIME PËRKATËSE FARMACEUTIK	13	MALLRA DHE SHËRBIME	1,777,000.00
10/216/28600/13/00000/0133	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASP	SHËRBIMET KONSULENTE	13	MALLRA DHE SHËRBIME	500,000.00
10/216/14700/13/00000/0113	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASP	EDITORATI I DREJTORIVE TË PËRGJITHSI	13	MALLRA DHE SHËRBIME	100,000.00
10/207/80500/13/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA E KULTURËS	13	MALLRA DHE SHËRBIME	61,405.00
Total kursime në Mallëra dhe Shërbime					2,838,405.00
10/203/40100/30/14530/0421	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHV	DEPARTAMENTI I POLITIKAVE BUJQËS	14530	TIMI DHE REHABILITIMI I SISTEMEVE TE UJTJES NE K	1,300,000.00
10/208/98100/30/19128/0950	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJI	INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PAR	19128	ALIZIM, PAJISJE ME KOMPJUTER, TABLA SMART E PRG	3,500,000.00
10/642/16322/30/52980/0133	MITROVICË JUGORE	ADMINISTRATA - MITROVICË	52980	BLERJA E SISTEMIT GPS PER VETURA ZYRTARE	8,000.00
10/642/73031/30/52920/0760	MITROVICË JUGORE	ADMINISTRATA - MITROVICË	52920	KOMBI PËR DIALIZ	38,000.00
10/642/93630/30/51970/0912	MITROVICË JUGORE	ARSIMI FILLOR - MITROVICË	51970	NDERTIMI I SHKOLLËS SE MUZIKËS	44,000.00
Total -Kursime në Shpenzime Kapitale					4,890,000.00
Total Kursime					7,728,405.00

Anex B (Ndarjet)

BLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Ndarje
10/216/14300/13/00000/0113	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTM	AMBASADAT - MPJ	13	MALLRA DHE SHËRBIME	600,000.00
10/243/23800/13/00000/0330	GJYKATA KUSHTETUESE	GJYKATA KUSHTETUESE	13	MALLERA DHE SHERBIME	32,000.00
10/626/73850/13/00000/0721	MAMUSHË	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIM	13	MALLRA DHE SHËRBIME	30,000.00
10/626/93390/13/00000/0912	MAMUSHË	ARSIMI FILLOR - MAMUSHË	13	MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00
Total Ndarje në Mallerë dhe Shërbime					677,000.00
10/651/85027/20/00000/0820	KOMUNA E GJILANIT	SHERBIMET KULTURORE	20	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	61,405.00
10/201/00100/20/00000/1020	MINISTRIA E FINANCEVE, PUNËS	PENSIONET BAZIKE - SOCIAL	20	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	1,000,000.00
Total Ndarje në Subvencione dhe Transferë					1,061,405.00
10/214/30400/30/19210/0310	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDS	SHËRBIMET E MBËSHTETJES	19210	ARMË DHE PAISJE SPECIALE TË P	5,900,000.00
10/642/17522/30/90161/0112	MITROVICË JUGORE	BUXHETI - MITROVICË	90161	IM:ME DONATOR TË BRENDSHEM	90,000.00
Total Ndarje në Shpenzime Kapitale					5,990,000.00
Total Ndarje					7,728,405.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/179
Datë: 21.12.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 2, nenit 23 dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/048 të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, me Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimi Nr. 42/178 i datës 13.12.2022, dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej gjashtëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e katër dhjetë euro e gjashtëdhjetë e dy cent (68,994,340.62 €) për zbatimin e Masës 3.5 - Shtesat për lehonat dhe shtesat për fëmijë dhe Masës 3.2- Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos për Ringjallje Ekonomike.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga nën-programet si në vijim:
 - 2.1 Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, merret shuma prej **55,261,722.32** euro nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.2 Nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, merret shuma prej **7,104,438.30** euro nga nën-programi "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga projekti "Projekti kapital/Kontigjenca në MF" me kod 18546, kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale";
 - 2.3 Nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, merret shuma prej **2,000,000** euro nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", burimi i financimit huamarrja 04; dhe
 - 2.4 Nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, merret shuma prej shuma prej **4,628,180.00** euro, nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", burimi i financimit 10;

3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij Vendimi ndahen në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në nën-programet si në vijim:
 - 3.1 Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201 ndahet shuma prej **40,994,340.62 euro** në nën-programin "Pagesa për Lehona dhe Shtesat për Fëmijë" me kod 09900, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 42/178 i datës 13.12.2023; dhe
 - 3.2 Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201 ndahet shuma prej **28,000,000 euro** në nën-programet me kod 00100, 00200, 00400, 01100, 01200, 01400, 02700, 02900, 03000, 03100, 00600, 00300, 02500 në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023. Shumat përkatëse për secilin nën-program sipas kësaj pike precizohen dhe shpërndahen nëpër këto nën-programe sipas përlllogaritjes së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Mjetet sipas këtij vendimi të ndara nga pika 2.1. e këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
5. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/179
Datë: 21.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në operacionin ndërkombëtar humanitar, sipas kërkesës së Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të dhënies së ndihmës humanitare në Republikën e Shqipërisë, në kërkim shpëtim.
2. Mjetet financiare për dërgimin e kontingjentit të FSK-së sipas pikës një 1. të këtij Vendimi, ndahen nga organizata buxhetore – Ministria e Mbrojtjes.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë Vendim t'ia dërgojë Presidentes me qëllim të dhënies së autorizimit të saj sipas legjislacionit në fuqi për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, si dhe të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës me përmbajtjen e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/179
Datë: 21.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/179
Datë: 21.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Bashkëpunimin Policor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Çeke.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë